




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep: <u>DPKI</u>	Nr Prot. Br. Prot. Prot No: <u>06-73/20</u>
Nr. Urag. Str. Shkencë Nr. Urag: <u>02</u>	Data Datum Date: <u>17-01-2020</u>



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 (paragrafi 4) të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.01.2020, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-01/19/017, për zyrtarin e lartë publik z. Arben Hoti, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për zyrtarin e lartë z. Arben Hoti, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Hoti, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtari i lartë publik, - Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, njëkohësisht mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat.

Për t'i vërtetuar dyshimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare me numër DPKI-06-2830-01/19 është konstatuar se z. Hoti mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat N.T.P "Maraton".

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare nr. AKK-DPKI-06-2737/19, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.



Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Hoti, Agjencia kundër Korrupsionit ka organizuar një takim me të, në të cilin është njoftuar për papajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik, konkretisht me atë se gjatë ushtrimit të funksionit si Gjyqtar, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë është e ndaluar me nenin 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesi.

Zyrtari i lartë z. Hoti, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare *DPKI-06-2737-1/19*, me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 15 paragrafi 2, si dhe nenit 19 paragrafit 1, pika 1.1 dhe 1.3 të LPKI, duke i transferuar të drejtat e administrimit, menaxhimit apo drejtimit të ndërmarrjes tek personi i besuar.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Hoti, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip HAVOLLI
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

